

MINISTRIA E KULTURËS**DREJTORIA E FINANCËS****RAPORTET E MONITORIMIT****12 - MUJORI -VITI 2017**

Programet Buxhetore:

- 1. Planifikim Administrim, Menaxhim**
- 2. Trashëgimia Kulturore dhe Muzetë**
- 3. Arti dhe Kultura**

RELACION**MBI MONITORIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE TË DYMBËDHJETË MUJORIT
TË VITIT 2017**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 130 dt 15.12.2016, “Për Buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” Udhëzimit Plotësues nr.8 datë 13.01.2017 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017” paragrafi IV “Monitorimi” Ministria e Kulturës, për 12-mujorin e vitit 2017, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore. Me anë të këtij relacioni prezantojmë në mënyrë të detajuar informacionin mbi realizimin e buxhetit për **12 - mujorin e vitit 2017**, ndarë sipas programeve dhe zërave ekonomikë.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore

Nr	Emri i programit	Plani 12– mujori 2017		Realizimi 12– mujori 2017		
		Në (000) leke	Struktura ne (%)	Në (000) leke	Struktura në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
1.	Planifikim, Menaxhim, Administrim	158,928	8.1%	155,001	8.2%	97.5%
2.	Trashegimia Kulturore dhe Muzete	510,268	26.1%	494,284	26%	96.9%
3.	Arti dhe Kultura	1,287,297	65.8%	1,251,764	65.8%	97.2%
	Totali	1,956,493	100%	1,901,048	100%	97.2%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se, buxheti është realizuar në masën 97%, ku rreth 66 % të totalit të shpenzimeve e zë zëri i shpenzimeve të programit “Arti dhe Kultura” buxheti i të cilit është realizuar në masën 97 %, ndjekur nga programi "Trashegimia Kulturore dhe Muzete" shpenzimet e të cilit zënë rreth 26 % dhe janë realizuar në masën 97% dhe programi "Planifikim Menaxhimi Administrim" shpenzimet e të cilit zënë rreth 8% të totali dhe janë realizuar në masën 98%.

Realizimi i fondeve buxhetore sipas zërave ekonomikë

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12- mujori 2017		Realizimi 12-mujori 2017		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12		600-601	Paga, Sig.Shoq	894,204	45.7%	884,496	46%	98.9%
12		602-606	Shpen.Korrente	483,023	24.7%	471,703	24.8%	97.7%
12		231	Kapitale	579,266	29.6%	544,849	28.7%	94.1%
			TOTALI	1,956,493	100%	1,902,181	100%	97.2%
			Shpenzime nga te ardhurat jashte limiti					
			TOTALI	1,956,493	100%	1,901,048	100%	97.2%

Sic vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se shpenzimet për 12-mujorin e vitit 2017 për paga dhe sigurime shoqërore janë realizuar në masën 99%, shpenzimet korente 98%, dhe shpenzimet kapitale janë realizuar në masën 94%.

Mosrealizimi i fondeve buxhetore në masën 2.8% ka ardhur kryesisht nga mosrealizimi i shpenzimeve kapitale dhe atyre kapitale.

Më poshtë po analizojmë realizimin e buxhetit sipas zërave dhe produkteve për çdo program buxhetor.

1. Programi: “PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM”

Për fondet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe shpenzimin e tyre si më poshtë;

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12–mujori 2017		Realizimi 12–mujori 2017		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	01110	600-601	Paga, Sig.Shoq	88,776	55.9%	85,489	55.2%	96.3%
12	01110	602-606	Shpen.Korrente	68,652	43%	68,019	44%	99.1%
12	01110	231	Kapitale	1,500	0.9%	1,492	1%	99.5%
			TOTALI	158,928	100%	155,001	100%	97.5%

MINISTRIA E KULTURËS

Sikurse vihet re edhe nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 98%, shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 56% të totalit dhe janë realizuar në masën 96%. Shpenzimet korrente zënë rreth 43% të totalit dhe janë realizuar në masën 99%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 1% të totalit dhe janë realizuar në masën 96%.

Mosrealizimi i fondeve në masën 2.5% konstatohet kryesisht në shpenzimet për paga e sigurime.

Fondet buxhetore të këtij programi janë organizuar në shtatë produkte, planifikimi dhe realizimi i të cilave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme. Sikurse vihet re nga të dhënat, konstatohet realizimi i produkteve.

Kodi i Programit	01110	Emertimi i programit:	Planifikim Menaxhim Administrim						
Qellimi 1									
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit të Performancës/Produktit	Emertimi i Treguesit të Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar në vitin korent	Niveli i rishikuar me vitin korent	Niveli i planifikuar për periudhën progresive	Niveli faktik në fund të vitit korent	% e Realizimit të Treguesit të Performancës/Produktit
Objektivi 1.1	Pemirësimi i legjislacionit ekzistues, hartimi i akteve të reja ligjore dhe nenligjore në përputhje me programin e qeverisë dhe detyrimet që rrjedhin nga MSA sipas fushës së veprimtarisë së MK	A-00323	Miratimi i legjislacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij	11,836	56,599	56,599	48,507	47,518	98%
Objektivi 2.1	Ngritja e kapaciteteve planifikuese dhe menaxhuese për stafine e MK-së për përbushjen me cilësi të raportimeve	B-00323	Administrata Funksionale		38,587	38,587	33,637	32,900	98%
Objektivi 3.1	Respektimi i procedurave ligjore në raport me të tretet dhe shlyerja në kohë e detyrimeve gjyqësore	C-00323	Zgjidhje e konfliktëve me të tretet dhe shmangie e detyrimeve të prapambetura	15,614	6,100	6,100	27,497	26,923	98%
Objektivi 3.2	Mirëmenaxhi dhe përdorim me efektivitet të fondeve buxhetore dhe reduktim të parregullsisë të konstatuar nën emrin e auditimeve të brendshme	D-00323	Zbatim të legjislacionit në fuqi për aparatin e MK dhe institucionet e varesisë	14,359	36,755	36,755	33,108	32,800	99%
Objektivi 1.5	Intenifikimi i bashkëpunimit rajonal dhe nderkombëtar dhe promovimi i kulturës nepërmjet fondeve dhe programeve të BE	E-00323	Mareveshje bilaterale të nënshkruara dhe aplikime për thithje fondesh në programe komunitare	20,721	15,235	15,235	14,679	13,368	91%
Objektivi 2.2	Pemirësimi i kushteve të punës për punonjësit e MK-së për përbushjen me cilësi të detyrave	F-00323	Instalime pajisje kompjuterike dhe pajisje të tjera të reja		2,000	2,000	1,500	1,492	99%
Objektivi	Pajisje dhe punime në ambientet e MK	G-00323		5,809					#DIV/0!
Objektivi	Menaxhim me efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare për realizimin e objektivave	I-00323		55,756					#DIV/0!
				124,095	155,276	155,276	158,928	155,001	

Nga sa mësipër rezulton se produktet e listuara nën këtë program janë realizuar pjesërisht. Në lidhje me realizimin e produkteve informojmë se procesi i ristrukturimit është kryer brenda numrit të përgjithshëm të MK-së në zbatim të Ligjislacionit në fuqi.

Për dymbëdhjetë mojin janë paguar pagat dhe sigurimet shoqërore për 65 punonjësit e MK-së.

Për sa i përket produktit “miratimi i legjislacionit dhe akteve ligjore në zbatim të tij” gjatë kësaj periudhe janë miratuar keto Aktet ligjore dhe nenligjore:

1. Projektvendim për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Theth dhe miratimin e rregullores së administrimit të tij.
2. Projektvendim për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për pasuritë Kulturore Kombëtare të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

3. Projektvendim për shpalljen e Qendrës Historike të fshatit Tragjas i Vjetër dhe miratimin e rregullores së administrimit të tij, etj.

Gjatë kësaj periudhe ka patur realizim të produktit “Zjdhje e konflikteve me te tretet dhe shmangie e detyrimeve te prapambetura”, pasi janë likuiduar një pjesë e mirë e vendimeve gjyqësore të prapambetura dhe të krijuara në atë periudhë.

2. Programi: “TRASHËGIMIA KULTURORE DHE MUZETË”

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatojmë planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

Gr	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12– mujori 2017		Realizimi 12– mujori 2017		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08220	600-601	Paga, Sig.Shoq	284,193	55.7%	279,822	56.5%	98.5%
12	08220	602-606	Shpen.Korrente	161,709	31.7%	156,019	31.5%	96.5%
12	08220	231	Kapitale	64,366	12.6%	58,442	11.8%	90.8%
			TOTALI	510,268	100%	494,284	100%	96.9%
			Shpenzime nga te ardhurat jashte limiti					
			TOTALI	510,268	100%	494,284	100%	96.6%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatojmë se buxheti është realizuar në masën 97%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 56 % të totalit dhe janë realizuar në masën 99%, shpenzimet korrente zënë rreth 32% të totalit dhe janë realizuar në masën 97% dhe shpenzimet kapitale zënë rreth 13% dhe janë realizuar në masën 99%. Mosrealizimi në masën 3.4% e totalit konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre.

MINISTRIA E KULTURËS

Kodi i Programit	08220	Emertimi i programit:	Trashëgimia Kulturore dhe Muzete						
Qellimi 1									
**Treguesit e performancës/Produktet:									
Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performances/Produktit	Emertimi i Treguesit te Performances***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhes	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar me vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performances/Produktit	
Objektivi 1.1	2 objekte te restauruara dhe muzealizuara te gatshme si produkt kulturor per publikun	G-00324	Objekte të resaturuara	112,521	70,000	70,000	48,491	48,161	99%
Objektivi 1.2	Parqe Arkeologjike dhe muze te mirembajtur ne menyre te vazhdueshme	H-00324	Muze parqe të mirëmbajtura	191,730	163,206	163,206	162,560	160,944	99%
Objektivi 1.1	Monumentet e Kultures te mirembajtura dhe inspektuara ne menyre te vazhdueshme	I-00324	Objekte të mirëmbajtura	213,698	191,238	191,238	230,029	226,078	98%
Objektivi 2.1	65 aktivitete te organizuara ne rang vendi	J-00324	Aktivitete, veprimtari kulturore	41,683	46,563	46,563	50,975	46,964	92%
Objektivi 1.3	500 elemente te trashegimise materiale e jomateriale te inventarizuara	U-00324	Objekte te inventarizuara	20,408	9,831	9,831	10,146	9,665	95%
Objektivi	Akte ligjore te ligjit te ri për Trashëgiminë Kulturore të hartuara dhe të miratuara	P-00324		2,171					#DIV/0!
Objektivi	Krijimi i qendrave te informimit publik per regjistrimin online të Pasurive Kulturore			27,513			8,066	2,472	31%
				609,724	480,838	480,838	510,268	494,284	

Muze dhe Parqe Arkeologjike me infrastrukturë të përmirësuar për të ofruar shërbim cilësor ndaj vizitorëve.

Aktiviteti kryesor i Muzeve Kombëtarë është promovimi, ruajtja, konservimi, restaurimi i objekteve dhe fondeve muzeore si dhe edukimi përmes trashëgimise dhe aktiviteteve në funksion të saj. Një komponent i rëndësishëm është dhe pasurimi me fonde dhe përmirësimi i prezantimit përmes ekspozitorëve dhe përshkrimeve të objekteve në nivele bashkëkohore.

Muzetë Kombëtar Krujë, Muzeu Kombëtar Ikonografik “Onufri”, Berat, Parku Arkeologjik Apoloni, Kalaja Gjirokastrë, Kalaja Shkodër, janë përfituese të projektit të AADF për vendosjen e biletarive elektronike te cilat që prej muajit Tetor 2017 operojnë me bileta për vizitorët përmes këtij sistemi.

Implementimi i këtij projekti bëri të mundur

- Instalimin e kabinave të biletarive ku janë vendosur pajisjet dhe gjithë infrastruktura teknike dhe logjistike për të garantuar menaxhimin e biletave dhe të vizitorëve.
- Vendosja e sistemit të kamerave në 7 sitet e trashëgimisë me qëllim monitorimin e procesit. Ky monitorim do të realizohet përmes dy monitorëve të vendosur në ambjentet e Ministrisë së Kulturës.
- U ndërtua infrastruktura e nevojshme për funksionimin e të gjithë sistemit në ambjentet e dhomës së serverave në Ministrinë e Kulturës. Përdorimi e infrastrukturës bashkëkohore teknologjike për sistemet e biletimit.

Njëkohësisht risitë e tij:

- Përmirësimin i shërbimit dhe performancës së institucioneve të trashëgimisë ndaj vizitorëve.
- Rritjen e transparencës fiskale përmes monitorimit në vazhdimësi të procesit dhe përfundimi të dhënave në kohë reale drejt institucioneve përfituese dhe Ministrisë së Kulturës.

Ka filluar dhe implementimi i Projektit “Të fuqizojmë muzetë nëpërmjet teknologjisë, për një qasje më të gjerë për të gjithë” nga AADF. Implementimi i këtij projekti pilot konsideron digjitalizimin e koleksioneve dhe zbatimin e teknologjisë ndërvepruese në hapësirat e tre muzeve kombëtar Muzeut Kombëtar Ikonografik “Onufri”, Berat; Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë si dhe Pavioni ikonografik në Muzeun Historik Kombëtar. Projekti angazhoi në Fazën I të tij fondin prej \$ 60.000 i cili u implementua falë bashkëpunimit të Ministrisë së Kulturës, Cultural Héritage Imaging – SHBA , Muzeut Kombëtar Ikonografik « Onufri » ; Muzeut Kombëtar të Artit Mesjetar, Korçë dhe Muzeut Historik Kombëtar.

Aktivitetet e Muzeve Kombëtare në vitin 2017 kanë konsistuar kryesisht në promovimin e vlerave të cilat administrohen nga këto institucione por njëkohësisht dhe programe të shumta edukative të cilat janë në përputhje me objektivin kryesor të muzeve formimi dhe informimi i brezit të ri.

Dita Nderkombëtare të Muzeve, 18 Maji, nën okelion “Muzetë dhe Historitë Tabu – të thuash të paimagjinueshmen” ka shënuar një sërë aktivitete në të gjitha institucionet muzeore në vend. Janë organizuar rreth 50 aktivitete në të gjithë vendin në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me shkollat.

Në prej aktiviteteve kryesore ishte dhe inaugurimi i Muzeut më të ri Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” në datën 23 Maj 2017.

Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Kulturës është bërë shpërndarja e 476 objekteve në pronësi të shtetit pas vendimit të Prokurorisë për kalimin në pronësi shtetërore të objekteve të sekuestruara nga Procesi “Thimio”. Këto objekte janë shpërndarë në Muzeun Kombëtar Historik, Muzeun Kombëtar të Artit Mesjetar, Arsimit dhe Arkeologjik, Korçë dhe në Muzeun Kombëtar Ikonografik “Onufri” Berat sipas procesverbale të mbajtura nga të gjithë institucionet pjesë e këtij procesi. Ky proces është depozituar për regjistrim edhe pranë Qendrës Kombëtar të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.

Muzeu Kombëtar të Fotografisë “Marubi”.

Muzeu Kombëtar i Fotografisë “Marubi” ka zhvillur veprimtarinë e tij në përputhje me objektivat për vitin 2017. Institucioni përveç performancës lidhur me vizitueshmerinë ka realizuar dhe aktivitete të tjera promovuese me qëllim publikimin e objekteve të trashëgimisë kulturore por njëkohësisht dhe përmbushjen e objektivit themelor Edukimit përmes trashëgimisë kulturore. Në këtë kuadër janë realizuar disa ekspozita dhe ëorkshope në ambjentet e këtij muzeu,

Muzeu Historik Kombëtar.

Gjatë 2017 janë realizuar një sërë veprimtarish me karakter promovues, edukues në të gjithë pavionet e këtij muzeu.

- Restaurimi i një sërë objekteve të trashëgimisë kulturore pjesë e fondit të muzeut.

- Ndërhyrjet konservuese të disa objekteve duke përfshirë dhe 9 objektet arkeologjike të cilat ishin pjesë e ekspozitës së përkohshme realizuar në kuadër të takimit të ministrave të kulturës të Evropës Juglindore në Tiranë.
- Angazhimi i MHK në pritjen e artistëve të rinj në kuadër të realizimit të Bienales së Mesdheut në Tiranë ku ambjentet të MHK kanë qenë pjesë e performancave të artistëve të rinj.
- Njëkohësisht pjesë e veprimtarisë së këtij institucioni kanë qenë dhe realizimet e veprimtarive dytësore si filmimet dhe fotografimet e objekteve muzeore nga subjekte të treta.
- Janë shënuar disa aktivitete në bashkëpunim me Arkivin e Shtetit falë marrëveshjes së përbashkët të këtyre dy institucioneve.

Muzeut Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë.

Veprimtaria e këtij muzeu përveç aktivitetit për pritjen e vizitorëve dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë ikonografike që administrojnë ky institucion aktiviteti kryesor ka qenë i përqëndruar në:

- Zhvendosjen e të gjithë fondit muzeor nga godina e vjetër në godinën e re
- Disfektimi i të gjithë fondin në aparaturën e dedikuar për këtë qëllim dhe vendosja e tyre në ambjentet e fondeve të reja
- Është realizuar zhvendosja e objekteve prej guri nga godina e re në godinën e muzeut arkeologjik
- Realizimi i ekspozitës në kuadër të 50 –vjetorit të vdekjes së studiueses bizantologe Vitori Puzanovës në ambjentet e këtij muzeu, në të cilën një koleksion mjaft me vlerë pjesë e fondit të këtij muzeu gjeti dritën e publikimit për herë të parë.

Muzeu i Arsimit, Korçë - Në ambientet e tij janë zhvilluar aktivitete në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historiko-kulturore të krahinës së Korçës dhe të Shqipërisë, ku janë ekspozuar fotografi, dokumenta, objekte të ndryshme, dhe janë shfaqur dokumentarë.

Qendra Kombëtare e Muzeumeve Berat,

Janë realizuar njëserë aktivitetesh me karakter promovues, edukues si dhe ngritje të kapaciteteve përmes trajnimeve si brenda dhe jashtë vendit. Një ndër aktivitet që shoqëron punën në muze ka qenë dhe pasurimi i fondit me objekte të reja si dhe përmirësimi i prezantimit tek publiku. Qendra Kombëtare e Muzeve, Berat i prezantoi publikut një produkt të ri të pa ekspozuara më parë, në kuadër të çeljes së sezonin turistik 2017. Gjithashtu janë zhvilluar aktivitete në kuadër të promovimit të vlerave të trashëgimisë kulturore nëpërmjet ekspozitave të ndryshme.

Muzetë Kombëtarë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” dhe Etnografik, Krujë.

Kryesisht puna në të dy muzetë është fokusuar të ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave muzeore që prezantohen për publikun si dhe në mirmbajtjen e dy muzeve si dhe janë realizuar disa aktivitetesh me karakter promovues dhe edukues për vizitorin si dhe përmes programeve mesimore të zhvilluara nga drejtorinë arsimore.

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë .

Muzeu Kombëtar Pavarësia Vlorë gjatë 2017 ka kryer një sërë aktivitetesh në përkujtim të figurave të shquara dhe ngjarjeve të rëndësishme historike-kulturore, ekspozita të artistëve të rinj, promovime librash , me fokus kryesor promovimin e trashëgimisë sonë kulturore. e vlerave muzeale.

Muzeu Kombëtar “Gjethi”.

Muzeu Kombëtar “Gjethi” ndonëse një muze i ri në hartën e muzeve në Shqipëri përveç një numri të lartë të vizitueshmërisë nga vizitorë vendas dhe të huaj ka realizuar një sërë aktivitetesh me karakter promovues dhe edukues.

Zyra e Administrimit Koordinimit Butrint me fondet e veta ka realizuar:

Konservim-restaurim i murit Butrint: Muri te Porta e Liqenit 32.1 ml dhe Muri i Akropolit, 4,730,252 lekë

Projekti i Konsolidimit të rrënojave te Kisha e Vogël dhe Godinës Helenistike në afërsi të Portës së Liqenit_Butrint/Sarandë, 853,200 lekë

Plani i rilevimit dhe përgatitja e hartës topografike për nënzonat A3 të Parkut Kombëtar të Butrintit 4,440,000 lekë

Hartimi projektit për punime konservuese dhe restauruese brenda zonës së qytetit antik të Butrintit, 8,880,000 lekë, Paketë Projektesh konservuese, restauruese, infrastrukture.

Hartimi i projektit për përmirësimin dhe rinovimin e sistemit të biletarisë elektronik, 275,400 lekë, Rinovim i sistemit elektronik i biletarisë.

Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Apoloni,

Përfunduan punimet restauruese në kuadër të projektit ***“Rehabilitimi i Manastirit të Shën Marisë për përdorim muzeal dhe peisazhit të Parkut Arkeologjik të Apolonisë”***, Fier financiar nga BE në kuadër të programit IPA multibeneficiary. Punimet u inaguruan në prill 2017.


Gjithashtu u realizua rihapja e portikut të statujave dhe riekspozimi i objekteve të portikut të statujave. Ndërhyrje me karakter mirëmbajtje janë realizuar në monumentet e agorasë dhe monumenteve të tjera të parkut. Gjithashtu janë kryer: rtifiksimi i tullave të shkëputura nga muret në monumentet: Tempulli Jonik, Prytaneoni, Harku i triumfit, Biblioteka, Odeoni, Dyqanet antike, Banesa me mozaik (D), rruga H, Banesa me impluvium dhe riparime të bëra me tulla dhe llaç në bordurën qarkuese të oborrit të muzeut.

Me financim të AADF në kuadër të Memorandimit të bashkëpunimit ndërmjet AADF dhe Ministrisë së Kulturës, në Park prej 10 tetor 2017 ka filluar funksionim biletaria elektronike.

Zyra e Administrimit dhe koordinimit të parkut Arkeologjik Bylis ka kryer pastrime nga vegjetacioni, mirëmbajtje dhe sperkatje me herbicide.

1. VIZITUESHMËRIA NË INSTITUCIONE DHE QENDRA TË TRASHËGIMISË KULTURORE GJATË VITIT 2017

Institucionet dhe qendrat e trashëgimisë kulturore gjatë 12- muorit (janar – dhjetor) 2017 janë vizituar nga **669,110** vizitorë vendas dhe të huaj nga të cilët **206,838** në muzetë kombëtarë, **261,074** në parqet arkeologjike dhe **201,198** në monumente të kulturës. Në totalin e përgjithshëm të vizitorëve numri i vizitorë me biletë dhe të ardhurat e gjeneruar prej tyre kanë njohur rritje progresive.



MINISTRIA E KULTURËS

TABELA PERMBLEDHËSE PËR VIZITORËT 1 JANAR - DHJETOR 2017							
Nr.	Emërtimi	Vizitorë vendas	Vizitorë huaj	Vizitorë me biletë	Vizitorë pa biletë	Totali Vizitorëve	Totali/ lekë
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	12,379	24,036	36,415	18,195	54,610	6,385,700
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	796	3,428	4,224	6,909	11,133	1,689,600
3	MUZEU I PAVARSISË VLORE	3,110	904	4,014	1,589	5,603	292,000
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË	8,689	14,212	22,901	8,460	31,361	4,361,980
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË	2,846	8,007	10,853	4,385	15,238	3,250,560
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	1,213	4,256	5,469	981	6,450	994,400
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	7,786	25,247	33,033	1,573	34,606	6,008,580
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË	1,891	3,150	5,041	5,377	10,418	2,631,500
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË	95	197	292	928	1,220	58,400
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË	9,568	4,850	0	14,418	14,418	0
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	2,847	4,633	7,480	4,881	12,361	4,050,700
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTEPIA ME	2,854	3,767	6,621	2,799	9,420	3,737,510
TOTALI MUZE		54,074	96,687	136,343	70,495	206,838	33,460,930
1	KALAJA BERAT	26,590	42,350	68,940	5,079	74,019	5,953,060
2	KALAJA GJIROKATËR	23,767	50,059	73,826	2,840	76,666	13,895,260
3	KALAJA PORTOPALERMOS	8,307	21,016	29,323	395	29,718	2,921,500
4	KALAJA E KANINËS	177	489	666	353	1,019	66,600
5	KALAJA E HIMARËS	780	2,780	3,560	352	3,912	356,000
6	AMFITEATRI	125	6,406	6,531	6,199	12,730	2,612,400
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	55	115	170	239	409	17,000
8	MANASTIRI I MESOPOTAMIT	250	1,860	2,110	615	2,725	211,000
TOTALI KALA E MONUMENTE TETJERE		60,051	125,075	185,126	16,072	201,198	26,032,820
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	66,043	83,164	149,207	18,552	167,759	64,636,300
2	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	10,123	8,986	19,109	10,032	29,141	6,590,600
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	1,016	1,884	2,900	1,066	3,966	727,500
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	15,833	33,672	49,505	3,205	52,710	9,545,880
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	1,110	1,420	2,530	110	2,640	253,000
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	88	231	319	863	1,182	63,800
7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	356	391	747	1,085	1,832	127,700
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	61	197	258	563	821	51,600
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	102	318	420	603	1,023	84,000
TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK		94,732	130,263	224,995	36,079	261,074	82,080,380
TOTALI NUMRI I VIZIOREVE		208,857	352,025	546,464	122,646	669,110	141,574,130


P.s Muzeu arkeologjik Durres dhe Amfiteatri funksionojnë me 1 biletë

2. ANALIZA KRAHASUESE NDËR VITE

Vizitueshmëria për periudhën Janar – Dhjetor në vitet 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017.


Analiza krahasuese e të dhënave statistikore ndër vite për periudhën Janar-Dhjetor 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje në vijimësi vit pas viti. Viti 2014 (12 mujori) ka shënuar **78,439** vizitorë më shumë se 2013, viti 2015 ka shënuar **59,438** vizitorë më shumë se 2014, viti 2016 ka shënuar **55,453** vizitorë më shumë se viti 2015 dhe viti 2017 ka shënuar **119,413** vizitorë më shumë se viti 2016.

Në krahasim me vitin 2013, vizitueshmëria gjatë vitit 2017 ka shënuar një rritje prej 105% dhe një trend vjetor në rritje mesatarisht prej 20%.



Analiza e kategorive të vizitorëve (me dhe pa biletë për periudhën vitet 2013-2014-2015, 2016 dhe 2017 evidentoi se të ardhura e gjeneruar kanë njohur rritje progresive. Grafiku në vijim.

Në krahasim me vitin 2013, të ardhurat gjatë vitit 2017 kanë shënuar një rritje prej 185% dhe një trend vjetor (2013-2017) në rritje mesatarisht prej 31%.



➤ **2 objekte të restauruara dhe muzealizuara të gatshme si produkt kulturor për publikun,**

Në vitin 2017 planifikimi i fondeve për investime në restaurimin e Monumenteve të Kulturës dhe Muzetë është në masën **51,200,000** lekë

Nga DPPSTK është ndjekur në vijimësi realizimi i investimeve të planifikuara për trashëgiminë kulturore :

- U realizua projekti për ngritjen e Muzeut Kombëtar të Përgjimeve “Shtëpia me Gjethe” dhe hapja për publikun në datën 23.05.2017.
- Përfundoi projekti “Rehabilitimi i Manastirit të Shën Mërisë për përdorim muzeal dhe rrethinat e sitit arkeologjik të Apolonisë Fier” financuar nga BE në kuadër të programit IPA multibeneficiary, TVSH e të cilit u financua nga buxheti I shtetit.
- Gjithashtu vazhduan punimet për përfundimin e “Rikonstruksion i banesës ku u ngrit Flamuri në Korçë” dhe “Regjistrimi i Pasurive Kulturore Kombëtare në Qendrat e Rregjistrimit fizik on-line”.

➤ **Monumentet e Kulturës të mirëmbajtura dhe inspektuara në mënyrë të vazhdueshme**

Në përmbushje të një prej objektivave të Ministrisë së Kulturës “Të ruajë, mbrojë dhe promovojë trashëgiminë kulturore”, Drejtoria e Trashëgimisë Materiale dhe Muzeve i kushton vëmendje të veçantë ruajtjes mbrojtjes dhe rehabilitimit të Monumenteve të Kulturës për t’i shndërruar ato në produkte turistike kulturore, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Kulturës Kombëtare, Parqeve Kombëtarë Arkeologjike si dhe me mbështetjen e IMK dhe ASHA.

Në vazhdim të eksperiencës në menaxhimin e fondeve për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, janë marrë masat për përdorimin me efektivitet të këtyre fondeve me synim mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës nëpërmjet konservimit, konsolidimit e restaurimit të tyre.

Janë kryer punime mirëmbajtje, konsolidimi pastrim vegetacioni dhe restaurimi **në rreth 145 Monumente Kulture** nga DRKK Durrës, Berat, Shkodër, Korçë, Gjirokastrë, Vlorë si dhe u përgatitën objektet e trashëgimisë kulturore për sezonin turistik gjithashtu vazhdon mirëmbajtja rutinë e tyre si dhe mbrojtja nga dëmtimet dhe degradimi nga agjentët atmosferikë.

Gjithashtu dhe **Parqet Arkeologjike kanë zbatuar projekte investime dhe mirëmbajtje** të cilat konsistojnë në përmirësimin e performancës së institucioneve të trashëgimisë aq edhe në ndërhyrje restauruese dhe mirëmbajtje në monumentet e kulturës.

Sipas Institucioneve janë kryer punime nga:

- **DRKK Durrës** ka kryer punime mirëmbajtje, pastrime nga vegetacioni i ulët dhe i lartë dhe ndërhyrje restauruese **në rreth 26 objekte Monument Kulture**. Janë kryer punime pastrime dhe mirëmbajtje periodike në Termat Romake , në Banesën Aleksandër Moisiu, Muret Rrethuese të qytetit të Durrësit, ne Mozaikun e Tiranës, ne Macellum Forum (Rotonda), “Ura e Tabakeve”, “Muri i Kalasë së Tiranës”, kalaja e Elbasanit, çezma dhe kalldrëmi në Rrapin e Bezistanit, Muzeu Arkeologjik Durrës, në Muret e Kalasë në Porto Romano, në Rrenojat e ndërtesës me mozaik, në Kalanë e Prezës, në Kalanë e Ishmit, në Pusin e Top Hanes, Rrenojat me mozaik, etj. Mirëmbajtje restauruese në Muret e Portës – Porto Romano Durrës,

mirëmbajtje në Mozaiku në Bazilikën e Shën Mëhillit- Arapaj Durrës, Dezinsektimi i Amfiterit Romak dhe Muzeut Arkeologjik Durres. Vendosja e Flamurëve në monumente dhe kala, etj.

- **DRKK Berat**, me specialistët dhe punëtorët e institucionit dhe në disa objekte dhe në bashkëpunim me pronarët ka kryer ndërhyrje restauruese, mirëmbajtëse, konsolidime, pastrime nga vegjetacioni i ulët dhe i lartë, **në 47 objekte monument kulture** kështu:

Punime mirëmbajtje restauruese në disa objekte në lagjen “Kala” si në objektet Kisha e shën Mitrit, Kisha e shën Evangjelizmoit, Sterna e Ujit, Fasada e banesës së z.Piro Heqimit, Restaurim i dritareve të banesës së z.Agim Deliu, Nderhyrje emergjente në murin rrethues të banesës së Thimie Xalit (Naço),etj. Pastrim nga vegjetacioni në Kishën e Shën Todrit, në Kishën e shën Evangjelizmoit, në Kishën e Shën Mari Vllahernës, Ndërhyrje emergjente në Kishën e "Ungjillizimit në Kozare, Pastrim në rrugicat kryesore të kalasë së Beratit.

Pastrim në rrugicat kryesore të lagjes “Mangalem”. Punime restaurimi dhe mirëmbajtje në disa banesa dhe monumente kulti dhe në lagjet “Goricë” dhe “Mangalem”. Restaurim Ikona “Mbledhja e Kryeëngjëjve” me autor Johan Çetirin, restaurim Ikona “Mbledhja e Kryeëngjëjve” me autor Kostandin Zografi. Restaurimi i Afreskut të Kishës së Shën Triadhës. Procesi i dizifektimit të Fondit të ikonave DRKK- Berat, Vendosje e tabelave informuese në portat e Monumenteve të kategorisë së parë në tre lagjet historike të qytetit të Beratit si dhe riparim i koshave dhe stolave prej druri në lagjen Kala.

- **DRKK Korçë**, ka kryer punime mirëmbajtje dhe pastrim nga vegjetacioni territorit në kishat e Voskopojës, Vithkuqit, Bazilikën e Linit, Restaurimi i mureve të Kishës së Ristozit, Restaurimi i Kishës së Shën Thanasit, Voskopojë, Restaurimi i Kishës së Shën Dhimitrit, Boboshticë, Restaurimi i Muzeut të Arsimit (ABC) Korçë.
- **DRKK Gjirokastrë**, ka kryer punime mirëmbajtje në rreth **30 objekte monument kulture**. Kështu u kryen punime Nderhyrje ne banesen "Koci" (prane Hamamit), Restaurim i çatisë së banesë "Beja", banesës "Koçi", banesës "Zhorda", dyqani "Papavangjeli "Pazar, Restaurim i çatisë pranë "Hamamit", Çatia banesa Zeko Palorto, etj. Restaurim i kalldremit ne kala, Realizim i kioskes prej druri per biletarine ne Parkun Arkeologjik të Antigonesë. Restaurim i portës së kishës në Labovën e Kryqit, Restaurim i portës "Toro", F/V dritare në banesën "Kokobobo", Dritaret banesa Çabej, banesa Çelo Partizani, Restaurim i portës "Naçi", Inspektim dhe pastrim në Kalanë e Lekëlit, Kishës së Shën Mëhillit dhe Kishës së Shën Thanasit në fshatin Lekël, Tepelenë, etj.
- **DRKK Vlorë**, u kryen punime mirëmbajtje, pastrim në **rreth 12 objekte monument kulture**, si dhe vendosje e tabela informuese në parqet arkeologjike. Mirëmbajtje objekti, P.A. Finiq, Manastirit të 40 Shenjtorëve, Sarandë , PA Orik, Mirëmbajtje objekti, godina e DRKK Vlorë, Mirëmbajtje në kishën e Shën Thanasit në Leshnicë, në kishën e Shën Spiridhonit në Vuno, Sarandë, Ndërtimi i Zyrës së Informacionit në P.A. Amantia. Vendosje tabelash shpjeguese në parqet arkeologjike të Amantias, Orikut dhe Finiqit dhe zëvendësimi i adezivëve të tabelave informuese në P.A. Orik.
- **DRKK Shkodër**, u kryen punime mirëmbajtje, pastrime dhe konsolidime në rreth **12 objekte monument kulture**. Konservim e restaurim në Kalanë e Shkodrës, si dhe mirembajtje e pastrim nga bimesia e lartë dhe e ulët. Punime konservimi e restaurimi në Muret antike të

Lezhës, në Kishën e Shen Stefanit, Blinisht, në Kishën e Shën Premtes, Gallatë, Kurbin në objektin Porta e Oborrit e familjes Ceka, etj. Panele informuese në Kalanë e Shkodrës dhe Kalanë e Lezhës si dhe Pastrim Mirëmbajtje dhe restaurim Ura e Mesit, Postribë, Shkodër .

ZAK Butrint, ka kryer:

- Konservim-restaurim i murit Butrint: Muri te Porta e Liqenit 32.1 ml dhe Muri i Akropolit 31.78 ml, 4,730,252 lekë.
- Projekti i Konsolidimit të rrënojave të Kisha e Vogël dhe Godinës Helenistike në afërsi të Portës së Liqenit_Butrint/Sarandë, 853,200 lekë.
- Plani i rilevimit dhe përgatitja e hartës topografike për nënzonat A3 të Parkut Kombëtar të Butrintit 4,440,000 lekë
- Hartimi i projektit për punime konservuese dhe restauruese brenda zonës së qytetit antik të Butrintit, 8,880,000 lekë, Paketë Projektesh konservuese, restauruese, infrastrukture.
- Hartimi i projektit për përmirësimin dhe rinovimin e sistemit të biletarisë elektronik, 275400 lekë, Rinovim i sistemit elektronik i biletarisë.

ZAKPA Apoloni. Rihapja e portikut të statujave, riekspozimi i objekteve të portikut të statujave. Gjatë vitit 2017 janë realizuar një sërë punimesh me karakter mirëmbajtjen e monumenteve. Ndërhyrje me karakter mirëmbajtje janë realizuar në monumentet e agorasë dhe monumenteve të tjera të parkut. Duke shfrytëzuar burimet materiale në magazinat e parkut janë bërë punimet e mëposhtëme:

Rifiksimi i tullave të shkëputura nga muret në monumentet: Tempulli Jonik, Prytaneoni, Harku i triumfit, Biblioteka, Odeoni, Dyqanet antike, Banesa me mozaik (D), rruga H, Banesa me impluvium dhe riparime të bëra me tulla dhe llac në bordurën qarkuese të oborrit të muzeut, kjo e fundit është ndërtuar në vitet ‘60.

➤ **65 Aktivitete të organizuara në rang vendi.**

Gjatë vitit 2017 Ministria e Kulturës dhe institucionet e trashëgimisë kulturore kanë organizuar dhe mbështetur një seri veprimtarish lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të ekspozuara in-situ ose të sjellë pranë publikut apo dhe të ekspozuara në ambientet e Ministrisë së Kulturës, si më poshtë:

I.Projekte me thirrje

1. Projekti “Ringjallja e teknikave të realizimit të xhubletës”. Projekt për ruajtjen dhe mbrojtjen e dihebërjes së xhubletes. Prill-Nëntor, Tiranë, Malësi e Madhe, etj. Organizatore Anila Zajmi Katanolli dhe Novatech Studio.
2. Projekti “Tirana si’xhade”. Lyerja e trotuarit të mesit në Sheshin ‘Nënë Tereza’ në formë sixhadeje. Maj , Tiranë. Organizatore Shoqata “RIAS”.
3. Projekti “EMATHIA”, botim, konference shkencore në gjurmë të trashëgimisë kulturore të krahinës së Matit. Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore të krahinës së Matit. Mars-22 Prill, Burrel. Organizator Artan Kurti.
4. Projekti “Fustanella Festival”. Koncerte, promovim i kengeve popullore dhe të perpunimit të tyre modern. 19-21 Maj, Gjirokastër. Organizator QK “REK-Remont Kapital”.
5. Projekti “Përmeti Multikulturor”. Festival Nderkombëtar Folklorik. Promovim i kulturave të pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë. 26-28 Maj, Përmet. Organizator Seksioni Shqiptar i CIOFF-it.
6. Projekti “Te mbajme të ndezur zjarrin e isopolifonisë tek brezi i ri”. Promovimi tek brezi i ri i vlerave të trashëgimisë kulturore jomateriale të krahinës së Librazhdit. Maj-Qershor, Librazhd. Organizuar nga Shoqata “Aks”.

7. Projekti “Edukimi i brezit të ri me vallet folklorike”. Edukimi i brezit të ri me vallen tradicionale të krahinës së Korçës. Maj-Qershor, Korçë. Organizator Koreografi Bardhyl Pojani.
8. Projekti “Edukimi i brezit të ri me këngën polifonike dhe vallja karakteristike Gjirokastrite”. Promovimi i vlerave të kenges dhe valles gjirokastrite tek brezi i ri. Prill-Korrik, Gjirokastrë. Organizuar nga artisti Roland Çenko.
9. Projekti “Edukimi i fëmijëve përmes trashëgimisë kulturore”. Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore tek brezi i ri, si kenges e valles popullore dhe artizanatit tradicional. Maj-Qershor, Përmet. Organizatore Arjana Todhe.
10. Projekti “Aulona Interfolk Festival”. Festival Folklorik Nderkombëtar. Ballafaqimi i vlerave të trashëgimisë jomateriale të popujve të ndryshëm. 11-13 Maj, Vlorë. Organizuar nga QK “Aulona”.
11. Projekti “Lirika në Divanin Lunxhiot”. Promovimi i vlerave folklorike dhe të kostumografisë të zonës së Lunxhit. 12 Maj në krahinën e Lunxhit, Gjirokastrë. Organizuar nga Shoqata Kulturore “Syri i Medias së Re”.
12. Projekti “Ekspozite figurative me punët më të mira të artistëve të Jugut”. Piktura me teme nga monumentet e trashëgimisë kulturore. Maj-Qershor, Gjirokastrë. Organizuar nga SHK “Roof Albania”.
13. Projekti “Ndërto të ardhmen në vendin tend”. Promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore të zones së Mirditës tek brezi i ri. Qershor, Mirditë. Organizator Armando Meta.
14. Projekti “Pasuritë e kulturës dhe kreativitetit të popullit në kostumografi”, Promovimi i dijetërisë së kostumeve. Qershor, Tiranë. Organizator Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë.
15. Projekti “Trajnim Marketingu Kulturor për të rinjtë”. Mundësitë për të promovuar vlerat e trashëgimisë tek vizitorët vendas dhe të huaj. 15 Maj-15 Qershor, Gjirokastrë. Organizator Shoqata “The gates of Horn and Ivory”.
16. Projekti “Mirdita Turistike”. Promovimi i vlerave turistike të zones së Mirditës. 1-25 korrik, Mirditë. Organizatore Odeta Taçi.
17. Projekti “Laboratori i Antropologjisë vizuale” ekspedite dhe ëorë shop. 03-09 Gusht, Prizren. Organizatore Blerina Hankollari.
18. Projekti “Lord Bajroni dhe miqtë”. Promovim i vlerave historike të trashëgimisë kulturore. Maj-Shtator, Tepelenë. Organizuar nga Shoqata “Argonaut”.
19. Projekti “Trashëgimia kulturore dhe tradita gjirokastrite” Broshurë, botim me monumentet e kultures. Shtator, Gjirokastrë. Organizator Klodian Muço.
20. Projekti “Promovimi i vlerave kulturore e historike të arkitektures”, flete-palosje, postera, etj. nga objektet arkitektonike të Gjirokastrës. Tetor-Nëntor, Gjirokastrë. Organizator Luiz Seiti.
21. Projekti “Udhëtim në kohë”, ekspozite pikturë. 29 tetor, Vlorë, Teatri “P.Marko”. Organizator piktori Edmond Kojani.
22. Projekti “Midis shekujsh”, ekspozite të instrumentave të vjetër popullorë. Maj-Nëntor, Tiranë, në MHK. Organizator Eral Sela.
23. Projekti “Trashëgimia Kulturore Jomateriale, pasuri e paçmuar për edukimin e të rinjve”, Edukimi i brezit të ri me vlerat e trashëgimisë jomateriale përmetare. Maj-29 Shtator, Përmet. Organizatore Shoqata SHASH.ARKEO shpk.
24. Projekti “Edukimi përmes librit, promovimi i botimeve të brezi i ri të autorëve nga Memaliaj”. Maj-Qershor, Memaliaj. Organizatorë Armand Hoxha dhe Anesti Halili.
25. Projekti “Heronjtë e monumenteve”. Qershor-Shtator, në rrethet e jugut. Organizatore CHëB-Albania.
26. Projekti Festivali Mbarëkombëtar “Oda Dibrane”, 09-11 nëntor, Dibër e Madhe dhe Peshkopi. Organizator Shk “Oda Dibrane”.

27. Projekti “Trashëgimia kulturore e Gjirokastrës” ëeb, Gjirokastrë, korrik-tetor. Organizator Luiz Seiti.

II. Aktivitete të Drejtorise së Trashëgimisë Jomateriale dhe Rijetëzimit të Gjuhës Shqipe.

1. Projekti “*Ruajtja e traditës zejtare të prodhimit të qilimave, transmetimi i dihebërjes te brezi i ri*”, prill-qershor, në Zogaj, Shkodër, organizuar nga znj. Nebije Qotaj, artizane.
2. Projekti “*Rikthimi i traditës së punimit në avlemend*”, prill-korrik, në Antigone, Gjirokastrë, organizuar nga Alketa Skëndaj.
3. Aktiviteti Nderkombëtar i Fluturimeve të Lira “*Argjiro Open*”, 23-26 mars në Gjirokastrë, në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Aeronautikës.
4. Projekti “*Panairi i kulinarisë*”, 22 prill, në Përmet, organizuar nga Drejtoria.
5. Projekti “*Tradita e dihebërjes së punimit artizanal të leshit, ndërtimi i staneve dhe punimi i kostumeve tradicionale*”, mars-korrik, në Gjirokastrë, Shoqata “*Rinia Europiane e Gjirokastrës*”.
6. Panairi i kulinarisë dhe artizanatit “*Udhët drejt historisë*”, 14-16 korrik në Libohovë nga Shoqata Open Doors for Albanian Youth-ODAY”.
7. Projekti “*Kampionati i 9-të Botëror i fluturimeve të lira*” (aktivitete kulturore shoqëruese) 05-14 maj, Federata Shqiptare e Aeronautikës.
8. Projekti “*Festivali i Lojrave Popullore në Parkun Arkeologjik të Amantias*”, 28 maj në Parkun Arkeologjik të Amantias Vlorë, në bashkëpunim me DRKK Vlorë.
9. Panairi i Kulinarisë, 28 maj në Kalanë e qytetit të Gjirokastrës, organizuar nga Drejtoria.
10. Projekti “*Muzeu i stilit Etno Vibe*” 29 shtator, në Muzeun Historik Kombëtar, Shoqata Kulturore “*Ti*”.
11. Projekti “*Takimi i shkollave për kengen dhe vallen labe*”, nëntor në Vlorë në bashkëpunim me DRKK Vlorë.
12. Projekti i ribotimit të monografisë “*Flamuri i Kombit Shqiptar*” të autorit Jaho Brahaj, organizuar nga Drejtoria.
13. “*Logu i Bjeshkëve*”, gusht 2017, Lepushe, Shkodër

III. Aktivitete për 29 Shtatorin dhe Ditët Europiane të Trashëgimisë- DRKK

DRKK Berat

Thesari i Vendit Tim Ekspozite me elemente arkeologjik, zejtar, arkitekturë, ekspozitë pamore në sit, gojëdhëna dhe mite mbi monumentet natyrore të zonës së Beratit.

DRKK Vlorë

Aktivitete në shkollat e Vlorës, Sarandës, Delvinës, Himarës, Dhërmiut, Vizita në site arkeologjike të zonës, Muzeun Arkeologjik Sarandë, Sinagogë, P A Finiq, Ekspozitë e arteve pamore “*Udhëtim në Kohë*” DRKK Vlorë dhe piktori Edi Kojani,

DRKK Shkodër “Trashëgimi dhe Natyrë”

DRKK Korçë “Trashëgimi dhe Natyrë”

Aktivitet në disa nga ambientet e brendshme të Muzeut Kombëtar të Arsimit.

Vizite me nxënës të shkollave 9 -vjeçare dhe gjimnaze në Shpellën e Trenit, në fshatin Tren, Korçë.

Vizatim në natyrë të objekteve Monument Kulturore.

DRKK Gjirokastrë

Panairi i gatimit tradicional gjirokatrit - Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore dhe biznesi i zonës muzeale organizuan në Kalanë e Gjirokastrës panairin e gatimeve tradicionale.

DRKK Durrës, në kuadër të 29 Shtatorit dhe Ditëve Europiane të Trashëgimisë u zhvillua një aktivitet ne Muzeun Arkeologjik Durrës: Demonstrim i procesit te pocerise: Tre artiste dhe mjeshtra te pocerise e qeramikes demonstuan ne audienca gjithe procesin e punes me argjilen, dhenien e formes deri te pjekja . 1- Seance didaktike me nxenesit e perzgjedhur nga shkollat e qytetit 2- Demonstrim per te gjithë qytetaret dhe vizitoret e Muzeut te asaj dite. Ne monitor do te kete filmime nga puna dhe prodhimet e pocerise ne ditet tona dhe nga puna ne fabriken e tullave, që përdor këtë aset natyror të qytetit. 4- Nje guide qe i dedikohet vetem artefakteve te muzeut te prodhuara me argjilen e Duresit u ofroa ate dite per vizitoret.

DRKK- Durres sektori Tiranë në bashkëpunim me shkollat e mesme të Tiranës zhvilluan një aktivitet në ambientet e Mozaikut të Tiranës

DRKK Durrës, sektori Elbasan organizoi me rastin e 29 Shtatorit dhe Ditëve Europiane të Trashëgimisë në bashkëpunim me bibliotekën publike “Q.Baholli” një ekspozitë me botime të përdikëve të vjetër të qytetit të Elbasanit .

IV. Aktivitete në kuadër të programit “Miku i Monumentit”, – janë zhvilluar nga Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore Rajonale kështu nga :

DRKK Vlorë

38 aktivitete me nxënës të 50 shkollave, në kuadër të programit “Miku i Monumentit” me tematika mbi monumentet më të rëndësishëm, elementë të ndryshëm të trashëgimisë materiale dhe jomateriale, veshjet popullore të trevave respektive, gatimet tradicionale, etj.

DRKK Gjirokastrë

20 aktivitete me nxënës të shkollave, në kuadër të programit “Miku i Monumentit” dhe “Edukimit përmes kulturës” etj. me tematika mbi monumentet më të rëndësishëm, elementë të ndryshëm të trashëgimisë materiale dhe jomateriale, veshjet popullore të trevave respektive, orë mësimi të hapura, panairë kulinarie etj

DRKK Berat

16 aktivitete me nxënës të shkollave, në kuadër të programit “Miku i Monumentit” dhe “Edukimit përmes kulturës” etj. si: “Takim në Laboratorin e Restaurimit” “Trashëgimia dhe Natyra”, “Edukimi Kulturor i Komunitetit Rom”, vizita në Muzeun Etnografik, orë mësimi të hapura, panairë kulinarie etj.

DRKK Shkodër

49 aktivitete me nxënës të shkollave, në kuadër të programit “Miku i Monumentit”, “Edukimit përmes kulturës” etj., si “Njohje me historikun e Kalasë Rozafë”, “Edhe ne luanim dikur” ekspozitë me lojra fëmijësh, regjistrimi në formular i mbartësve të Trashëgimisë Jomateriale ne te gjithë territorin qe ka nen administrim DRKK Shkodër, “Ditet dibrane e matiane” me panairë artizanati, ekspozitë shëtitëse “Arkeologji dhe natyrë”, “Dita e Diversitetit Kulturor”, etj.

DRKK Durrës

36 aktivitete me nxënës e studentë si: “Trashëgimia kulturore në duart e të rinjve”, “Vizita të nxënësve në Mozaikun e Tiranës”, “Aktivitet për Konstandin Kristoforidhin”, apo me publikun e gjere si: “Festimet e Ditës së Verës në qytetin e Elbasanit”, “Festivali i XII i Muzikës së Dhomës” në Muzeun Arkeologjik Durrës, Ekspozita "PA DRITË" në Muzeun Etnografik të Gjakovës, Festa e Mjaltit, Librazhd, etj

V. Veprimtari të organizuara nga Drejtoria e Trashëgimisë Materiale dhe Muzeve dhe Institucionet.

Në kuadër të objektivave për vitin 2017, DTMM dhe institucionet e sistemit të trashëgimisë kulturore kanë organizuar një seri veprimtari lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që kanë pasur për qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore, ngritjen e kapaciteteve

profesionale në sistemin e saj përmes pjesëmarrjes në ëorkshope/ konferenca, trajnime dhe takime kombëtare dhe ndërkombëtare, kështu janë zhvilluar:

- Konferenca Ministeriale e Këshillit të Ministrave të Kulturës të Evropës Juglindore (CoMoCoSEE) në kuadër të Presidencës së Shqipërisë së CoMoCoSEE 21-22 shkurt 2017
- “Konferencë Kombëtare Trashëgimia Motor Zhvillimi” Prill - Korrik 2017.
- Aktivitet në nderim të arkeologut Vangjel Toçi, në kuadër të 18 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve”
- Aktivitet kulturor me rastin e 50- vjetorit të vdekjes së bizantologes ruse Viktori Puzanova, si dhe ekspozitë me veprat e saj 18 Prill 2017
- Ceremonia e kthimit të ikonës “Zoja e Shkodrës” restauruar nga specialistet e Institutit “Palazzo Spinelli”, Firenze, si dhe promovimi i veprës së restauruar, 25 Prill 2017.

Nga institucionet e trashëgimisë kulturore në nivel vendi janë realizuar një sërë aktiviteteesh të cilat kanë patur në fokus edukimin përmes trashëgimisë kulturore por edhe promovimin e këtyre vlerave përmes ekspozitave të ndryshme të përkohshme dhe lëvizëse. Janë realizuar 180 aktivitete dhe 40 ekspozita.

➤ **500 Elemente të trashëgimisë materiale e jomateriale të inventarizuara**

Ministria e Kulturës nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore, punon për krijimin dhe përditësimin e Rregjistrimit Kombëtar të Pasurive Kulturore, inventarizimin dhe katalogimin informatik të trashëgimisë kulturore të popullit shqiptar, krijimin e një database unike për trashëgiminë kulturore të luajtshme dhe të paluajtshme, materiale dhe jomateriale për të gjitha kategoritë e poseduesve si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të pronësisë dhe të lëvizjes, me qëllim identifikimin, katalogimin dhe ruajtjen e saj.

Rregjistrimi i objekteve kulturore konsiston në hedhjen e një mori informacionesh që bazohen te kartela tip që lëshon QKIPK.

Në vitin 2017 QKIPK shënon **30,424 objekte** të rregjistruara dhe kataloguara në Databazën Kombëtare të Pasurive Kulturore, e cila administrohet nga QKIPK.

Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore dhe Ministria e Kulturës përfituese e projektit të asistencës nga UNESCO në shumën 20.000 USD kanë realizuar një sërë aktiviteteesh si Konferenca dhe Ëorkshopi “Lufta kundëra trafikimit të pasurive kulturore; sfida dhe nevoja për ndërgjegjësim” si dhe botimi në shqip dhe anglisht i Katalogut të objekteve të humbura 1990 – 2016 si dhe përkthimit në shqip të Kodit për tregtarët e pasurive kulturore (botim i UNECO-s).

Objektivat kryesore të Projektit “Ndërtimi i kapaciteteve dhe promovimi i inventarit të dixhitalizuar të pasurive kulturore dhe lufta kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore”, janë:

- Ndërtimi i kapacitete të stafit shqiptar të administrimit lidhur me metodat e luftës kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore dhe sistemin ligjor përkatës në vend.
- Ndërtimi i kapaciteteve të stafit shqiptar të aministrimit lidhur me inventarizimin e pasurive kulturore, bazuar në standardet ndërkombëtare, si hap i parë për mbrojtjen.
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi format e lëvizjes së paligjshme të pasurive kulturore.

1. **Programi: “ART DHE KULTURA”**

MINISTRIA E KULTURËS

Në lidhje me shpenzimet e këtij programi, konstatohet planifikimin dhe realizimin e tyre si më poshtë:

G r	Prog.	Art.	Emërtimi	Plani 12– mujori 2017		Realizimi 12– mujori 2017		
				Në (000) leke	Strukt. ne (%)	Në (000) leke	Strukt. në (%)	Në (%) ndaj buxhetit
12	08230	600-601	Paga, Sig.Shoq	521,235	40.5%	519,184	41.5%	99.6%
12	08230	602-606	Shpen.Korrente	252,662	19.6%	247,664	19.8%	98%
12	08230	231	Kapitale	513,400	39.9%	484,915	38.7%	94.5%
			TOTALI	1,287,297	100%	1,251,764	100%	97.2%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme konstatohet se buxheti është realizuar në masën 97%. Shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë rreth 41% të totalit dhe janë realizuar në masën 100%. Shpenzimet korrente zënë rreth 20% të totalit dhe janë realizuar në masën 98%. Shpenzimet kapitale zënë rreth 40 % dhe janë realizuar në masën 95%. Mosrealizimi i fondeve në masën 2.8% konstatohet kryesisht në shpenzimet kapitale.

Në tabelën e mëposhtme, jepen të detajuara produktet e planifikuara dhe realizimi përkatës i tyre

në (000) lekë

Kodi i Programit	08230	Emërtimi i programit:	Arti dhe Kultura						
Qellimi 1									
			**Treguesit e performancës/Produktet:						
	Objektivat e politikës:	Kodi i Treguesit te Performancës/Produktit	Emërtimi i Treguesit te Performancës***/Produktit	Niveli faktik i vitit paraardhës	Niveli i planifikuar ne vitin korent	Niveli i rishikuar me vitin korent	Niveli i planifikuar per periudhen progresive	Niveli faktik ne fund te vitit korent	% e Realizimit te Treguesit te Performancës/Produktit
Objektivi 1.1	Investime te reja te skenave leatrore bashkekohore	A-00325	Pemiresimi I sherbimeve ne infrastrukture ne institucionet kulturore ne vend	3,545	685,800	685,800	513,400	484,915	94%
Objektivi 1.2	Aktiviteti artistik ne 10 insitucione qendrore te Artit dhe Kultures	B-00325	Kalendarët artistik dhe të edukimit përmes kulturës pranë 7 institucioneve qendrore të artit në vend	197,690	603,554	603,554	658,846	653,775	99%
Objektivi 1.3	Aktiviteti artistiko kulturore te inicuar nga MK, sipas prioriteteve institucionale dhe integriteti gjinor	C-00325	Kalendari I projekteve me thirrje nga MK	18,111	92,200	92,200	81,330	79,354	98%
Objektivi 1.4	Perfaqsimi ne programe dhe evenimente nderkombetare	D-00325	Integrimi I kulturës shqiptare në përfaqësime ndërkombëtare prestigjioze	7,199	20,232	20,232	33,720	33,720	100%
				226,545	1,401,786	1,401,786	1,287,297	1,251,764	97%

Produktin (A): Investime të reja të skenave teatrore bashkëkohore

Drejt përfundimit procesi i punës në lidhje me Investimet dhe ndërtime të reja të skenave bashkëkohore, rikostruksione infrastrukturë në nivel qendror dhe vendor në institucionet e artit dhe kulturës si dhe hapësira të reja rikualifikimi;

- TKOB (ne proces pune)
- Teatri Migjeni, perfunduar.
- Teatri Andon Zako Cajupi, Korçë (Në muajin Qershor 2017 u realizua Inagurimi)
- Skena e Re (drejt përfundimit)
- Godina e Vetingut (ish –Ministria e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, në proces), perfunduar.

Produkti (B): Aktiviteti artistik ne 10 institucione qendrore të Artit dhe Kulturës

Për realizimin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2017, Drejtoria e Krijimtarisë dhe Edukimit përmes Kulturës në zbatim të politikave dhe Programit Art-Kulturë 2017-2019, ka vijuar nga puna për arritjen e objektivave bazuar në Planifikimin e Buxhetit afat mesëm si dhe dokumentit që shoqëron atë Deklaratën e Politikës së Programit.

Sa më sipër, në bashkëpunim me të gjithë institucionet e vartësisë dhe iniciativave private në këtë fushë është konkluduar sipas parashikimeve realizimi i projekteve artistike kulturore, të cilat kanë siguruar gjithpërfshirje në jetën social kulturore, në veçanti ato projekte të cilat kanë në fokus krijimtarinë artistike, edukimin dhe zhvillimin e audiencave si dhe integrimin gjinor. Projektet artistike me program aktivitetesh jashtë territorit të Shqipërisë kanë treguar rritje të nivelit artistik dhe nivelit të përfaqësimit përmes promovimit të produktit artistik shqiptar dhe nxitjes së konkurrencës mes protagonistëve në fushën e art kulturës.

Krijimtaria artistike në çdo disiplinë të artit vijon të shfaqë interes për skenat ndërkombëtare dhe ndjehet një rritje interesi për bashkëpunime të përbashkëta kulturore, fakt që garanton qëndrueshmëri të produktit me periudha afat gjata.

Një nga objektivat e parashikuar për tu përmbushur si një detyrim me prioritet të lartë ligjor, në kuadër të realizimit të objektivave me bazë gjinore të programit “Arti dhe Kultura”, tashmë vijon integrimi dhe përfshirja e buxhetimit gjinor në Programin Buxhetor Afatmesëm, 2017-2019.

Produkti C: Aktiviteti artistiko kulturor të inicuar nga MK, sipas prioriteteve institucionale dhe integritetit gjinor.

1. Thirrja për projekt-propozime për vitin 2017 Projektet e përzgjedhura për mbështetje në Art&Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor

Ministria e Kulturës, më 1 dhjetor 2016 shpalli thirrjen për projekt-propozime për vitin 2017 në Art&Kulturë, e cila u mbyll në datë 13 janar 2017. Kolegjiumi i Ministrisë së Kulturës mori në shqyrtim rreth 230 projekt-propozime në art, kulturë dhe trashëgimi kulturor, nga të cilat përzgjodhi 127 projekte fituese. Edhe në këtë thirrje, ashtu si në vitin e kaluar, ka ardhur në rritje interesi i aplikantëve me propozime, ide dhe projekte të subjekteve, organizatave. Kolegjiumi i përbërë me ekspertë të vlerësimit dhe zhvillimit të politikave dhe strategjisë kulturore, vlerësoi fituese projekt-propozimet që përputhen me kriteret e shpallura në udhëzuesin që shoqëroi thirrjen për projekt-propozime, projektet që shprehin: ide novatore, garantojnë cilësi dhe profesionalizëm në realizim, qëndrueshmëri dhe vazhdimësi, mundësi për rritjen profesionale të artistit, sjellin zhvillim dhe gjallërim të skenës artistike e kulturore në Shqipëri, dëshmojnë respektimin e të drejtës së autorit; Veçojmë **edukimin përmes artit dhe kulturës, krijimtarinë artistike dhe përkrahjen e të rinjve** duke filluar nga potenciali i tyre krijues e deri tek **punësimi i tyre, rritjen e audiencave, shtrirjen gjeografike** dhe kohore, si dhe **aftësia për të thithur fonde nga burime të tjera**.

<i>Projektet fituese per vitin 2017</i>	
<i>Emertimi projektit</i>	<i>subjekti</i>
Different Trains Festival	Different Trains
Pop Rock Symphony Ladies	Kozeta Kurti
International Albania Brass Festival	Artistet Interprete
Tinguj dhe monumente	Gezim Belegu
Festivali Nderkombetar I Muzikes Baroke	Qendra Vox Baroque
Netet e Muzikes Klasike	Haig Zacharian;Florian Vlasi
Festivali I 12-te Nderkombetar I Muzikes se Dhomes	Arti dhe Kultura Italo-Shqiptare
Muzika e Dhomes dhe Krijmtaria e saj	Shoqata ``Skampa``
Festivali Multikulturor Berat Edicioni 4-te 2017	Njerez dhe Ide
100 vjetori I lindjes se kompozitorit Prenke Jakova	Shoqata Kulturore Artistike ``Preng Jakova``
Festivali Mbarkombetar I Kenges per Femije	Shprti Artistik Shkodres
Ribashkim Muzikor	Eriona Jaho
Konkursi Nderkombetar ``Kenget e Tokes``	Qendra e Menaxhimit Artistik ``Kenget e Tokes``
Nokturn Pranveror	Instituti Pages Zhvillimit Inovacionit Acli-Ipsia
International Festival Jazz in Albania	Syri Blu
Jo vetem MOZART	Gejenerata e Re
Rapsodite Shqiptare	Vasil Tole
Romanca Shqiptare	Endri Sina
Nete Magjike Shqiptare	Volart Production
Festivali muzikes moderne edicioni-6	Eugjen Gargjola
Maratona Kenges	Qendra per Zhvillimin Komunitar ``Sot per te Ardhmen
Nata e Kitares	Edison Miso
Pianodrom	Fondacioni per Zhvillimin e Kompozicionit
Shen Peterburg dhe grupi I te Pesteve	Enica Selenica

Ne tingujt e historise	Qendra per Zhvillim Ekonomik dhe Maredhenie Nderkombetare
Festivali nderkombetar I zerave te rinj ``Jorgjie Truja``	Takuina Adami
Rozafa Expression	Rozafa Expression 2017
Albanian Dance Meeting Festival edicioni I 12-te	Durres Beauty
Kopelia	Arian Plaku
Here lart here poshte	AR-KU Fondacion
Shqiptaret ne Artin boteror	Ferid Hudhri
Ciceroni Virtual	Metroresearch (Universiteti Metropol Tirane)
Dizanji per te ardhmen-2017	Universiteti Polis
Festivali I Piktures	Qebdra per edukimin ekonomik dhe biznesin
Bienalja Nderkombetare e Akuarielit 2	Shoqata Kulturore Vizart
Frumezime nga kronika e nje qyteti ne gur	Open Doors
Diktatura Komuniste ne 360 grade	Cross Culture Lab
Ekspozite-Konkursi nderkombetar I fotografose artsistike ``Prefoto`` edic.7	Edon Agushi;Ervin Cala
Dashuri permes ngjyrave	Shoqata ``Liburnetik``
Art House	Consulting and Development Partners
Kam nje pyetje	Instituti Studimeve Politike
Promovimi I Artisteve bashkekohor Shqiptar	Zeta Galeri
``Art, femijet dhe muzeu``	Giada Kuka
Skulptura e realizmit socialist	Maks Velo
Cikli I plote I menaxhimit te nje projekti kulturor	Arben Papadhopuli
Strip Art Al	Endrit Beqo
Skulptura e Parkut	Genti Tavanxhiu
Double Feature	Tirana Art Lab
Nekrologji Urbane	Sadik Spahia

Teatri I rruges neper Shqiperi	Shoqata Artisteve te Rinj te skenes
Festivali Mbarkombetar I Komedise ``KoKoFest``	CDC-Community Development Center Albania
Zgjim/Aeaking Edicioni 19-te	Shoqata Europiane Teatri Bashkohor Shqiptar A.T.K.
Festivali 15-te Nderkombetar I Teatrit ``Butrinti 2000``	Res Egnatia
Festivali 14-te Nderkombetar I Melodrames ``ALBAMONO 2017``	Dhimitraq Orgocka
Cifti Cuditshem	Shoqata ``Bloom``
Butka Medeas	Erjona Kakeli
Kaloresi	Shoqata Artistike Klaus`Film
Fasulja	Unioni Shqiptar per zhvillimin sociaal
Kontrabasi	Stefan Capaliku
General & PlayBoy	Bujar Kapexhiu
Aktoret jemi ne	Shoqata ``Pertej Barrierave``
Quhem Ballkan	MAM Foundation
Ballkan Teater Tirana Fest	Shoqata ``Ballkan Teater Tirana Fest``
Detektivi	Artan Imami
1917-2017 Triologjia e heshtjes se kuqe	ELECTRAL
Mushkrite	Erdit Asllani
Treg I Lire	Kastriot Shehi
Inok Arden	Rudin Lengo
Shfaqja qe shkoi per dreg	Qendra Ceapalnet
5 Djelmoshat	Helidon Fino
Dama me kamelie	Luljeta Hoxha
Sylvia	Gjergj Mena
TIFF 2017 edicioni 15	Tirana Film Institute
Dea OpenAir International Film Festival	Multi media Studio ``Nositi``
Festivali Nderkombetar Filmit per Student ``First step Film Fest``	Shtepia Filmike d`ART
Festivali Filmit Ballkanik dhe Artit Kulinar	Art-Im-Pulse

Festivali Filmit nderkombetar, Kinemaja e shoqerise ardhme ``A-FestFilm 2017``	Anifest
Tirana 48 hour film project	Qendra ``Bind``
Festivali Nderkombetar I Filmit per te Drejtat e Njeriut ne Shqiperi	Ora Film Marubi
Balkan`s gate	Shoqata Zejtaret dhe Mjeshtrit duararte Pogradecare
Mbi semantikes e brutales dhe Poetikes salle ne MHK	Shoqata ``Ura``
Ekspozita Vjetore e piktures ``Nentori`` salle ne MHK	Aleksander Filipi
Andrra	Diana Malaj/Qendra Rinore ATA

Projekte të brendshme, nga programi art-kulturë zëri 604:

1. Projekti Parku i Artit në bashkëpunim me Rajonin e Puglias

Ministria e Kulturës në planin e saj të gjetjes dhe transformimit të hapësirave për zhvillimin e artit dhe kulturës në Tiranë, ka nisur punën për projektimin dhe përshtatjen e territorit të ish-Kinostudios në Kopështin e Artit.

Qëllimi i projektit "Parku i Artit" është krijimi i një hapësire ekspozimi të përkohshëm dhe të përhershëm për veprat e artistëve të rinj e më gjerë duke ndërthurur frymën bashkëkohore të artit dhe formulimin e hapësirave gjatë procesit të projektimit.

"Parku i Artit", është një projekt që rivitalizon parkun natyror dhe kthen në një hapësirë arti. Projekti titullohet "Shokët dhe engjëjt", një projekt për një hapësirë-kopsht dedikuar Antonio Gramsci-t në qytetin e Tiranës. konceptuar nga Alfredo Pirri, artist dhe arkitekt me ekspozita ndërkombëtare.

Ky projekt sjell një rifunksionalizim të parkut për një pol të ri kulturor dhe për të parë në dritën e filozofisë së Antonio Gramshit skulpturat e realizmit socialist. Ky do të jetë një debat i gjerë kulturor, lidhur me figurën e Antonio Gramshit". Vetëm një vit e gjysmë më parë Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Universitetet e Arkitekturës prezantoi konkursin për përshtatjen e territorit të ish-Kinostudios në Kopshtin e Artit. Qëllimi i projektit ishte krijimi i një hapësire ekspozimi të përkohshëm dhe të përhershëm për veprat e artistëve të rinj e më gjerë. Një ide e hershme në platformat kulturore të MK kthimi i territoreve të brendshme në një park për art dhe medium, për të gjitha stinët, për aktivitete sociale, kulturore e ekspozita të hapura, për ngjarje rinore e jo vetëm, pa kufij gjinish dhe formash, madje edhe ato më të guximshmet. Ky projekt ka mbështetjen e Regione Puglia-s dhe Fondacionit "Antonio Gramshi".

2. Projekt-filmin “Gjirokastra” (*Sorkadhet e trembura, gratë ruse*) me skenar letrar të autorit Ismail Kadare, me Drejtor Artistik Aleksandër Sokurov, Drejtor Filmi Yuri Arabov, Autor Ismail Kadare.

Shtëpia filmike Albimage, ka realizuar një bashkëproduksion ndërkombëtar për skenarin letrar të autorit Ismail Kadare. Në këtë projekt janë përfshirë përveç Shqipërisë dhe Federatës së Rusisë, Italia, Franca dhe Belgjika. Filmi do xhirohet në Shqipëri, më së shumti në Gjirokastrë dhe më pak në Moskë dhe Tiranë. Këto janë qytetet ku do të xhirohet historia e dashurisë mes Katias ruse dhe Arianit shqiptar gjatë regjimit totalitar, frymëzuar nga libri “Sorkadhet e Trembura” të Ismail Kadaresë.

Ky film besohet se mund të përsërisë suksesin e bashkëprodhimit të parë shqiptaro-rus në vitin 1953 për filmin “Skënderbeu”. Filmi “Gjirokastra” (*Sorkadhet e trembura, gratë ruse*) vjen për kinematografinë shqiptare si një ngjarje me rëndësi në një bashkëpunimin filmi ndërmjet profesionistëve të kinemasë botërore. Në këtë bashkëprodhim, janë përfshirë profesionistë si kineast, aktorë, regjisorë, producentë, kostumograf, skenograf, piktor, kompozitor nga Shqipëria, Rusia, Franca, Italia.

Përsa i përket kuotave të bashkëfinancimit, në % dhe autoritete financuese janë si më poshtë:

Rusia: 45,75% (Ministria e Kulturës, TV, kontribut i kompanisë filmike, etj) Itali: 17,41% (Ministria e Kulturës, fond publik, TV, kontribut i kompanisë filmike, etj) Shqipëria: 20,09 % (Ministria e Kulturës, TV, Kontribute nga partner ndërkombëtar, etj). Shtete të tjera (Franca, Belgjika, Maqedonia): Ministrinë e Kulturës, fonde publike, TV, kontribute të kompanive filmike.

Vlera financiare e buxhetit të përbashkët për mbulimin e projektit filmik është 1.493.000€. Shqipëria mbulon 20,06 % të produktit filmik, e vlerësuar shumë 300.000 €, sipas projektit dhe tabelave të kontributeve për çdo partner. Mbështetja financiare ka ardhur pas shumë takimesh dhe letërkëmbimesh në nivel ndërmjetor të Ministrive të Kulturës respektive dhe Ministrive të Jashtme, si dhe entitetsh të rëndësishme ndërkombëtare që në veprimtarinë e tyre kanë mbështetjen e krijimtarisë dhe industrive kinematografike.

Përsa i përket, kontributit të palës shqiptare, fondet në dispozicion të programit “art-kulturë” të Ministrisë së Kulturës për vitin 2017, janë të planifikuara dhe të mbyllura. Për këtë duke mos pas në dispozicion vlerën e mjaftueshme për realizimin e filmit, MK ka kërkuar nga MF me shkresën nr. 3402, datë 25.05.2017 mendim për projektvendim “Për një shtesë fondi Ministrisë së Kulturës në buxhetin e miratuar për vitin 2017, për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e produksionit filmik “Gjirokastra, sorkadhet e trembura, gratë ruse”. KM/MF, ka miratuar shtesë fondi në buxhet të MK, për vitin 2017 për realizimin e produksionit filmik “Gjirokastra, sorkadhet e trembura, gratë ruse”. Kjo na bëhet e ditur nga MF, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit me shkresën nr. 7564, datë 20.11.2017, për miratim detajimi të Aktit Normativ nr. 3, datë 6.11.2017, shtesa Aparati në Art me vlerën 20.000.000 lekë.

Fazat e projektit:

- Periudha përgatitore 72 ditë
- Periudha e xhirimeve: 42 ditë
- Periudha e pas produksionit: 120 ditë

3. Aktiviteti kulturor “Gëzuar, Gëzuar, Gëzuar: Festo me Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor”, 25 dhjetor 2017, në Pallatit të Brigadave.

Në kuadër të aktiviteteve kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvilluara nga Ministria e Kulturës, Institucionet qëndrore të artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore në vend, duke përfshirë gjithë bashkëpunëtorët, operatorët kulturor të cilët janë angazhuar dhe kanë dhënë kontribut në arritjet dhe praktikën më të mira gjatë vitit kalendarik 2017 si dhe bazuar në prioritetin e 4-vjeçarit e ardhshëm “Edukimi përmes Kulturës”, u realizua aktiviteti kulturor në nder të trupave artistike, Institucioneve më të rëndësishme publike të Artit, Kulturës dhe Trashëgimisë Kulturore në vend.

Të pranishëm, institucionet si : TKOBAP, QKKFTK, TK, GKA, TKEKS, CK, BK, MHK, IMK, ASHA, QIKPK, QKVF, (Drejtoritë rajonale TK), bazuar në treguesit e tyre vjetor të kalendarëve artistik me aktivitete të shumta brenda dhe jashtë vendit, ku faktojnë një rritje të ndjeshme të cilësisë në produktet artistike dhe audiencës së pranishme përmes shifrave dhe statistikave zyrtare, mbi vizitorët vendas dhe të huaj, rritjes së interesit të lartë nga turistët, etj. Gjithashtu, subjektet e shumta artistiko-kulturore si shoqata, OJF, grupe artistike apo artistë emergjentë të cilët përgjatë vitit 2017, kanë krijuar produkte artistike, krijuar mundësira punësimi për të rinjtë dhe kanë qenë një hapësirë shumë e mirë e aplikimit të skenës së pavarur dhe rritjes profesionale në disiplina të ndryshme artistiko-kulturore.

Aktiviteti kulturor me titull “Gëzuar, Gëzuar, Gëzuar: Festo me Art-Kulturë dhe Trashëgimi Kulturor”, 25 dhjetor 2017, u mbajt pranë Pallatit të Brigadave, të ftuar grupet artistike. Pjesë e repertorit të këtij koncerti ishin Koret e bashkuara, Kori i studentëve, Kori i personave me aftësi të kufizuara (që nuk shikojnë), performancë rreth 50 minuta program festiv në skenë me shoqërimin e orkestrës së harqeve, me Band-in, grupe instrumentistësh profesionistë, grupi i baletit për fëmijë, etj

Produkti D, Përfaqësimi në programe dhe evenimente ndërkombëtare

1. Bialja e mesdheut “Mediterranea 18” , 4- 9 Maj 2017, në Tiranë dhe Durrës. Për herë të parë, Tirana është kthyer në “shtëpinë” e 230 artistëve të rinj nga Mesdheu dhe Europa, pjesëmarrës në edicionin e 18 të Bienales së Artistëve të Rinj “Mediterranea 18”, duke e renditur vendin tonë në axhendat kulturore ndërkombëtare. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, vizitoi dje në mbrëmje disa nga aktivitetet e organizuara nga artistët pjesëmarrës. “Jam shumë i lumtur që e gjithë Tirana është mbushur me aktivitete. Dua ta përdor këtë mundësi për të ftuar të gjithë qytetarët, por sidomos të rinjtë, duke qenë se edhe 230 artistët që na kanë ardhur nga e gjithë Europa, Mesdheu, janë të rinj dhe shumica e artit provokon ide të rinia.

'Mediterranea 18' përfundoi fazën e përgjdhjes së artistëve të rinj nga Evropa dhe Mesdheu, të cilët aplikuan pas hapjes së thirrjes për aplikim më 14 nëntor deri në mbylljen e saj më 20 Janar 2017. Më shumë se 800 artistë nga vendet anëtare të BJCEM-it dhe rreth 80 artistë shqiptar aplikuan për tu bërë pjesë e Bienales që u mbajt përgjatë periudhës 4- 9 Maj 2017, në Tiranë dhe Durrës.

2. Vlashent Sata në Festivalin Ndërkombëtar Kulturor “Balkan Trafik 2017”

Përfaqësimi i Shqipërisë në Edicionin e 11 Jubilar të Festivalit Ndërkombëtar Kulturor “Ballkan Trafik”, që u mbajt në datat **20 - 24 prill 2017 (më datë 22 Përfaqësimi i Shqipërisë me artistin Vlashent Sata)**. Sqarojmë se për arsye të njëanshme nga pala organizatore , Artistisi Vlashent Sata nuk ishte pjesë e programit e artistik dhe Edicioni i (1-Rë) në Paris, në datat 1- 4 Qershor 2017”.

“Balkan Trafik” konsiderohet si një nga aktivitetet më të rëndësishme të Evropës Juglindore, në të cilin prezantohet arti dhe kultura tradicionale në një ballafaqim vlerash ndërkulturore, që për çdo vit tërheq një audiencë të konsiderueshme, shprehet parimisht dakort duke sugjeruar ngritjen e një Kolegjiumi, që do të krijojë dhe miratojë të gjitha aspektet logjistike, artistike dhe financiare për përfaqësimin e Shqipërisë me dinjitet dhe nivel të lartë artistik në këtë veprimtari ndërkombëtare.

3. Përfaqësimit të Pavijonit Shqiptar në Edicionin e 57-të të Bienales së Artit në Venecia të Italisë, që do të mbahet më 13 Maj – 26 Nëntor 2017”,

Pavijoni me titull “Ndodhi në kohën e tashme”, prezantoi Shqipërinë përgjatë ceremonisë së inaugurimit të **“Pavijonit Shqiptar në Bienalen e Venecias, 2017”, më datë 11 Maj 2017 ora 14:00**, pranë (Padiglione All’arsenale), kati parë, ndërtesa A. Venezia, Itali.

Hapja zyrtare e pavijonit u mbajt më datë 11 maj, por ajo vijon e hapur nga 13 Maj - 26 Nëntor të vitit 2017. Përvec miqve të ftuar nga organizatorët gjatë hapjes morrën pjesë shumë emra të rëndësishëm të botës ndërkombëtare të artit. Ceremonia u hap nga z. Mirela Kumbaro, Ministre e kultures, artisti: Leonard Qylafi dhe kuratorja: Vanessa Joan Müller. Në ceremoni mori pjesë edhe kryeministri i Republikës Shqipërisë z. Edi Rama, kuratorë, kritikë arti dhe gazetarë.

Titulli i zgjedhur nga kuratorja Christine Macel, për edicionin e 57 të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit është: “Viva arte viva”. “Në një botë plot konflikte dhe trazira, në të cilën humanizmi po vihet seriozisht në rrezik, arti është pjesa më e vyer e qenies njerëzore.

Është vendi ideal për reflektim, krijimtarinë individuale, lirinë dhe pyetjet themelore. Është një “po” ndaj jetës, edhe pse një “por” i qëndron nganjëherë përkrah. Më shumë se kurdo, roli, zëri dhe përgjegjësia e artistit janë të domosdoshëm në kuadrin e debatit bashkëkohor” ka shpjeguar projektin e saj Christine Macel.

Pavjoni shqiptar “Ndodhi në kohën e tashme”, projekt fitues nga artisti Leonard Qylafi dhe kuratorja Vanessa Joan Müller në konkursin e hapur nga Ministria e Kulturës. Arsyeja përse u përzgjedh ky projekt ishte se “Ndodhi në kohën e tashme” prezantohet nga një artist që ka aftësinë të risjellë historinë e së shkuarës me një këndvështrim, kërkim dhe praktikë kontemporane.

Artisti L. Qylafi u prezantua me piktura dhe dokumente personale që sjellin një kontrast midis historive individuale dhe kujtesës kolektive, në një trajtim sa politik, aq edhe poetik. Duke e krijuar lidhjen e tij me kohën, Qylafi arriti të prodhojë një ngjashmëri dhe analogji të fortë dhe të re, e cila ngre shumë pyetje, duke e bërë edhe më emocionuese potencialin e dinamikës së narrativave të paraqitura”. Leonard Qylafi (datëlindja 1980) është artist kontemporan shqiptar që punon në medime të ndryshme si: video, fotografi, muzikë dhe pikturë.

Projekti me temë: “Legjenda e një Kështjelle”

Në kuadër të zhvillimit të politikave përfaqësuese për artin pamor shqiptar përtej kufijve ky projekt, është zhvilluar nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me Fondacionin “Kalo Art” në organizimin e ekspozitës me titull; “Legjenda e një Kështjelle”, në Selinë e Gjykatës

Europiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, Francë 9 janar – 3 shkurt 2017. Ekspozita ka pasë në përmbajtje 20 piktura e skulptura, krijimtari të artistëve Shkodranë më të mirënjohur dhe artistë të gjeneratës së re të cilët i bashkon tema e Kështjellës së Shkodrës dhe legendës së saj. Kjo ide bashkëpunimi, synoi evidentimin dhe promovimin e arteve pamore shqiptare nëpërmjet rritjes së shikueshmërisë përtej kufijve, në vlerësim të veprimtarisë artistike të piktorëve të njohur të qytetit të Shkodrës gjatë shek. XIX – XX. Siç janë Kolë Idromeno, Andrea Kushi, Simon Rota, Zef Kolombi dhe brezave të piktorëve pasardhës. Nga kjo plejadë artistësh Shkodranë, kanë ardhë studentët e parë piktorë të cilët ekspozuan pikturat e tyre në publik të quajtur “Miq të Artit”, dhe që synuan krijimin e një Galerie Kombëtare Arti. Këta piktorë shkodran u bënë shkaku i zanafillës së shkollës së parë shqiptare e hapur si fillim në qytetin e Shkodrës dhe më mbas, u hap shkolla e parë e vizatimit në janar 1932 në Tiranë nga piktori Andrea Kushi dhe artisti Italian Mario Ridola. Fondacioni “Kalo Art”, nëpërmjet Galerisë “Kalo”, është evidentuar si një ndër iniciativat më serioze në vendin tonë, dedikuar promovimit të artistëve dhe arteve figurative shqiptare shqiptarë dhe më gjerë.

Projekti me temë: “Cittadellarte 2017”

Ky projekt u zhvillohet në kuadër të një eksperience shumë të vlefshme bashkëpunimi institucional zhvilluar gjatë vitit 2016, mes Fondacionit Pistoletto dhe Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, për pjesëmarrje të dy artistëve të rinj shqiptarë të arteve pamore në Programin Rezidencial Ndërkombëtar në Universitetin e ideve “Cita dell Arte”, Biella, Itali. Programi UNIDEE për këtë vit do të zhvillohen me një seri modulesh javore të hapura për pjesëmarrje të artistëve, kuratorëve, studentëve dhe hulumtues ndërkombëtar, nëpërmjet një kursi që do të kurohet thellësisht nga mentor të ftuar me një program, të konsultuar dhe të pranuar nga autoritetet e Universitetit të Ideve. Programi është planifikuar të zhvillohet nga datat 16/27 tetor 2017 – me tematikë: “*le sottili urgenze*”, me mentor Adrian Paci, të ftuar Leonardo Caffo (filozof), Zef Paci (profesor Arti), në Cittadellarte, Biella & Art House, Shkodër, Albania, drejtuar dhe kuruar nga Cecila Guida, në bashkëpunim me Juan Esteban Sandoval, nën kujdesin e Drejtorit të Përgjithshëm të Fondacionit “Pistoletto” z. Paolo Naldini. “Citta dell Arte” - përfshin dy koncepte, atë të qytezës e cila është një fushë në të cilën arti është i mbrojtur mirë, dhe atë të qytetit që korrespondon me idenë e hapjes dhe ndërlidhjeve komplekse me botën si një laborator i madh, si një gjenerator i energjisë krijuese i cili zhvillon proceset përgjegjëse në transformimin e strukturës shoqërore në sektorë të ndryshëm. Universiteti i ideve është një platformë, që ofron një program edukativ në shumë aspekte, si një qytet arti mes artistësh ndërkombëtarë, partnerë akademikë, kritikë e personalitete arti.

Për këtë vit nga MK, do të mbulohen shpenzimet për dy artistë të rinj shqiptarë të arteve pamore në formën e një pagese “*Fee pjesëmarrje*” në programin Rezidencial Ndërkombëtar, dhe udhëtimit ndërkombëtar.

Projekti “Artist in Residence”

Projekti u zhvillua nga datat 28 Prill – 31 Maj, në Salsburg, Austri 2017.

Ky projekt është zhvilluar në vijim të një bashkëpunimi të suksesshëm në mëse 2 vjet, që rrjedh nga Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Republikës së Austrisë dhe Republikës së Shqipërisë, si dhe Protokollit të Bashkëpunimit midis Landit të Salzburgut, Austri dhe Ministrisë së Kulturës, Shqipëri. Kjo veprimtari gjatë viteve në zhvillim ka sjell një impakt shumë pozitiv në nxitjen dhe konsolidimin e krijimtarisë artistike për artistët Shqiptar dhe Austriak. Artistët shqiptarë gjatë qëndrimit në rezidenc, kanë jetuar eksperiencat të reja dhe janë frymëzuar në veprat e tyre nga njerëzit, pejsazhi dhe diversiteti kulturor që kanë ofruar vendet përkatëse duke shkëmbyer, eksperiencat bashkëpunimi të vlefshme në krijimtarinë individuale artistike. Përsa i përket angazhimit financiar të palëve në Protokollin e

Bashkëpunimit, Pala pritëse mbulon akomodim gjatë qëndrimit të artistit si dhe studion e punës vendin; sillën e ekspozimit të punëve që artisti krijon gjatë kohës së rezidencës; si dhe mundëson kontaktet e nevojshme me artistë dhe Institucionet e artit, vizita, takime, etj. Ministria e Kulturës, ka mundësuar udhëtimin dhe Dieta (kuot ushqimore) të artistit/es gjatë periudhës kohore të qëndrimit në rezidencën Salsburg, Austri.

(Informacion më i detajuar dhe i specifikuar sipas indikatorëve dhe treguesit përkatës për secilin nga Institucionet e artit dhe Kulturës, bashkëlidhur tabela statistikore për 12 mujorin e vitit 2017